



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr. 106

Datë 9 korrik 2014

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM
nr.430, datë 2.7.2014

Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Universitetit të Tiranës.....

4161

Vendim i KM
nr. 442, datë 4.7.2014

Për kalimin në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të objektit “Salla VIP e Aeroportit “Nënë Tereza”” dhe për një ndryshim në vendimin nr. 229, datë 23.4.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e ceremonialit zyrtar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....

4162

Vendim i KM
nr. 443, datë 4.7.2014

Për miratimin e lëvizjes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të 30 (tridhjetë) skulpturave të kompleksit skulpturor “Satira në skulpturë”, të autorit Uran Hajdari, nga fondi i Galerisë Kombëtare të Arteve, pranë ambienteve të Galerisë Kombëtare të Kosovës, me qëllim ekspozimin e tyre në Ekspozitën Ndërkombëtare, “Çmimi Muslim Mulliqi 2014, Edicioni X”.....

4163

VENDIM**Nr. 430, datë 2.7.2014****PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËTËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI UNIVERSITETIT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shetëtorë, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Universitetit të Tiranës.

Lista me 3 (tre) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 18 (tetëmbëdhjetë).

2. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, Universiteti i Tiranës dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama****LISTA E PRONAVE TE UNIVERSITETIT TE TIRANES**

Institucioni i Pushtetit Qëndror Ministria e Arsimit dhe Sporteve											
Bashkia Tiranë											
Fusha e përdorimit të pronës Universiteti I Tiranës											
NR	Z. Kadastrale & In. Hartes	Nr. Pasurie	Lloji I Prones	Komuna / Bashkia	Emri I Prones Adresa	Sip. Tot. e Prones (m2)	Sip. Godine ne Prone (m2)	Funksioni I prones	Institucioni qe administron pronen	Institucioni Perdorues	Akti normativ I lenies ne administrim
1	8160 S - 13	5/80,86	God. + Truall	B. Tirane	Fakulteti I Ekonomise God. A (6 Kat)	4500	800	Arsim	U T	Fak. I Ekonomise	Vendimit Nr 834 dt 13.12.2006
2	8160 S - 13	5/80,244	God. + Truall	B. Tirane	Fakulteti Ekonomise God. B (3 Kat)		1250	Arsim	U T	Fak. I Ekonomise	Vendimit Nr 834 dt 13.12.2006
3	8160 S - 13	5/61,63,6 0,61K	God. + Truall	B. Tirane	Fakulteti Histori e Filologji	8200	1100	Arsim	U T	FaK. Hist. e Filo.	Vendimit Nr 834 dt 13.12.2006
4	8160 S - 13	5/61,63,6 0	God. + Truall	B. Tirane	Fakulteti Gjuhe te Huaja		1800	Arsim	U T	Fak. Gj. te Huaja	Vendimit Nr 834 dt 13.12.2006
5	8270 ST - 11	5/158	God. + Truall	B. Tirane	Fak. Drejtesi	2330	1200	Arsim	U T	Drejt.	Vendimit Nr 834 dt 13.12.2006

6	8350 M - 11	5/80	God. + Truall	B. Tirane	Fak. I Shkencave Nat. God. A	8824	1634	Arsim	U T	Fak. Shkenca Nat.	Vendimit Nr 834 dt 13.12.2006
7	8350 M - 11	5/80	God. + Truall	B. Tirane	Fak. I Shkencave Nat. God. B		830	Arsim	U T	Fak. Shkenca Nat.	Vendimit Nr 834 dt 13.12.2006
8	8350 M - 11	5/80	God. + Truall	B. Tirane	Fak. I Shkencave Nat. God. C		1037	Arsim	U T	Fak. Shkenca Nat.	Vendimit Nr 834 dt 13.12.2006
9	8350 M - 11	5/80	God. + Truall	B. Tirane	Fak. I Shk. Nat. Ambiente Ndhimese		140	Arsim	U T	Fak. Shkenca Nat.	Vendimit Nr 834 dt 13.12.2006
10	s'ka	s'ka	God. + Truall	B Sarande	Filiali I fakultetit te Ekonomikut	7000	630	Arsim	Bashkia Sarande	Fakulteti Ekonomik	
11	8160 S - 12	7/13	God. + Truall	B. Tirane	Rektorati & Garazhet	1660	1000	Arsim	U T	Rektorati	Vendimit Nr 834 dt 13.12.2006
12	s'ka	s'ka	God. + Truall	B Kukes	Filiali I fakultetit te Ekonomikut	528	308	Arsim	B. Kukes	Fakulteti Ekonomik	

13	s'ka	s'ka	God. + Truall	B. Tirane	Muzeu I shkencave	1296	560	Arsim	FSHN	Fak. Shkenca Nat.	NR 653 dt 14/09/2011
14	8270 U,V - 9,10	0/0	God. + Truall	B. Tirane	Kopeshti Botanik	1E+05	90	Arsim	U T	Fak. Shkenca Nat.	Vendimit Nr 834 dt 13.12.2006
15	8160 S - 14 tlr.	5/37	God. + Truall	B. Tirane	Kino Klubi Studenti	1390	1220	Arsim	U T	Rektorati	Vendimit Nr 92 dt 27.01.2009
16	s'ka	s'ka	God. + Truall	B. Tirane	Fak Shkencave Sociale	1069	6076	Arsim	U T	Rektorati	Vendimi Nr 648 dt 29/09/2011
17	s'ka	s'ka	God. + Truall	B. Tirane	Instituti Fizikes Berthamore	16200	2400	Arsim	U T	Rektorati	Vendimit Nr 563 dt 22.08.2007
18	s'ka	s'ka	God. + Truall	B. Tirane	Departamenti i Bioteknologjise		404	Arsim	U T	Rektorati	Vendimit Nr 563 dt 22.08.2008

VENDIM
Nr. 442, datë 4.7.2014

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
TË OBJEKTIT "SALLA VIP E AEROPORTIT
"NËNË TEREZA" DHE PËR NJË NDRYSHIM
NË VENDIMIN NR. 229, DATË 23.4.2004, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR
MIRATIMIN E CEREMONIALIT ZYRTAR NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15 të ligjit nr. 8743, datë 31.7.2000 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", dhe të neneve 12, pika 2 e 49, të ligjit nr. 9095, datë 3.7.2003, "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së

Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, për "ALBCONTROL", sh.a.-në, të objektit "Salla VIP e Aeroportit "Nënë Tereza", pjesë e pasurisë numër 201/3, në zonën kadastrale nr. 3183, Rinas.

2. Salla VIP e Aeroportit "Nënë Tereza", brenda destinacionit të saj, do të përdoret nga "ALBCONTROL", sh.a.-ja, e cila do të ofrojë edhe shërbimet që ofrohen aktualisht nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, sipas rregullave të miratuara nga ministri i Punëve të Jashtme dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

3. Shërbimet e protokollit të shtetit në “Sallën VIP të Aeroportit “Nënë Tereza””, do të vijojnë të drejtohen nga Zyra e Protokollit të Shtetit, në varësi të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

4. “ALBCONTROL”, sh.a.-së, i ndalohet të ndryshojë destinacionin e objektit “Salla VIP e Aeroportit “Nënë Tereza””.

5. Nënndarja 2.5, e pikës 2, “Përdorimi i sallës VIP të Aeroportit”, të kapitullit V, “Vizita dhe takime”, të ceremonialit zyrtar në Republikën e Shqipërisë, bashkëlidhur vendimit nr. 229, datë 23.4.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shfuqizohet.

6. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe “ALBCONTROL”, sh.a.-ja, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 443, datë 4.7.2014

**PËR MIRATIMIN E LËVIZJES JASHTË
TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
TË 30 (TRIDHJETË) SKULPTURAVE TË
KOMPLEKSIT SKULPTUROR “SATIRA NË
SKULPTURË”, TË AUTORIT URAN HAJDARI,
NGA FONDI I GALERISË KOMBËTARE TË
ARTEVE, PRANË AMBIENTEVE TË GALERISË
KOMBËTARE TË KOSOVËS, ME QËLLIM
EKSPOZIMIN E TYRE NË EKSPOZITËN
NDËRKOMBËTARE, “ÇMIMI MUSLIM
MULLIQI 2014, EDICIONI X”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 19, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e lëvizjes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të 30 (tridhjetë) skulpturave të kompleksit skulpturor “Satira në skulpturë”, të autorit Uran Hajdari, nga fondi i Galerisë Kombëtare të Arteve, pranë ambienteve të Galerisë Kombëtare të Kosovës, për t’u ekspozuar në Ekspozitën Ndërkombëtare, “Çmimi Muslim Mulliqi 2014, Edicioni X”, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Koha e qëndrimit të këtyre objekteve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të jetë nga data 7 korrik-5 shtator 2014.

3. Ekspozimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të bëhet në përputhje me udhëzimin nr. 2, datë 18.3.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për lëvizjen e objekteve të trashëgimisë kulturore të luajtshme, me vlera të veçanta kombëtare dhe unike, për restaurimin, studimin dhe ekspozimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

4. Ngarkohen Galeria Kombëtare e Arteve të kryejë shoqërimin dhe kthimin e skulpturave në vendin e origjinës pas mbarimit të veprimtarisë dhe Qendra e Inventarizimit të Pasurive Kulturore të kryejë regjistrimin e lëvizjes së objekteve.

5. Ngarkohet Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E VEPRAVE TË PËRZGJEDHURA PËR EKSPozIM NË “ÇMIMIN MUSLIM MULLIQI 2014”**organizuar nga Galeria Kombëtare e Kosovës**

Nr.	Autori	Titulli i veprës	Teknika	Nr. Inv.
1	Uran Hajdari	Kompleksi skulpturor “Satira në skulpturë” – pjesa 1	Baltë e tharë (e papjekur)	1682
2	Uran Hajdari	Kompleksi skulpturor “Satira në skulpturë” – pjesa 2	Baltë e tharë (e papjekur)	1682
3	Uran Hajdari	Kompleksi skulpturor “Satira në skulpturë” – pjesa 5	Baltë e tharë (e papjekur)	1682
4	Uran Hajdari	Kompleksi skulpturor “Satira në skulpturë” – pjesa 6	Baltë e tharë (e papjekur)	1682
5	Uran Hajdari	Kompleksi skulpturor “Satira në skulpturë” – pjesa 11	Baltë e tharë (e papjekur)	1682
6	Uran Hajdari	Kompleksi skulpturor “Satira në skulpturë” – pjesa 12	Baltë e tharë (e papjekur)	1682
7	Uran Hajdari	Kompleksi skulpturor “Satira në skulpturë” – pjesa 13	Baltë e tharë (e papjekur)	1682
8	Uran Hajdari	Kompleksi skulpturor “Satira në skulpturë” – pjesa 15	Baltë e tharë (e papjekur)	1682
9	Uran Hajdari	Kompleksi skulpturor “Satira në skulpturë” – pjesa 17	Baltë e tharë (e papjekur)	1682
10	Uran Hajdari	Kompleksi skulpturor “Satira në skulpturë” – pjesa 18	Baltë e tharë (e papjekur)	1682
11	Uran Hajdari	Kompleksi skulpturor “Satira në skulpturë” – pjesa 20	Baltë e tharë (e papjekur)	1682
12	Uran Hajdari	Kompleksi skulpturor “Satira në skulpturë” – pjesa 22	Baltë e tharë (e papjekur)	1682

13	Uran Hajdari	Kompleksi skulpturor “Satira në skulpturë” – pjesa 29	Baltë e tharë (e papjekur)	1682
14	Uran Hajdari	Kompleksi skulpturor “Satira në skulpturë” – pjesa 33	Baltë e tharë (e papjekur)	1682
15	Uran Hajdari	Kompleksi skulpturor “Satira në skulpturë” – pjesa 34	Baltë e tharë (e papjekur)	1682
16	Uran Hajdari	Kompleksi skulpturor “Satira në skulpturë” – pjesa 38	Baltë e tharë (e papjekur)	1682
17	Uran Hajdari	Kompleksi skulpturor “Satira në skulpturë” – pjesa 42	Baltë e tharë (e papjekur)	1682
18	Uran Hajdari	Kompleksi skulpturor “Satira në skulpturë” – pjesa 47	Baltë e tharë (e papjekur)	1682
19	Uran Hajdari	Kompleksi skulpturor “Satira në skulpturë” – pjesa 55	Baltë e tharë (e papjekur)	1682
20	Uran Hajdari	Kompleksi skulpturor “Satira në skulpturë” – pjesa 57	Baltë e tharë (e papjekur)	1682
21	Uran Hajdari	Kompleksi skulpturor “Satira në skulpturë” – pjesa 58	Baltë e tharë (e papjekur)	1682
22	Uran Hajdari	Kompleksi skulpturor “Satira në skulpturë” – pjesa 59	Baltë e tharë (e papjekur)	1682
23	Uran Hajdari	Kompleksi skulpturor “Satira në skulpturë” – pjesa 60	Baltë e tharë (e papjekur)	1682
24	Uran Hajdari	Kompleksi skulpturor “Satira në skulpturë” – pjesa 65	Baltë e tharë (e papjekur)	1682
25	Uran Hajdari	Kompleksi skulpturor “Satira në skulpturë” – pjesa 69	Baltë e tharë (e papjekur)	1682
26	Uran Hajdari	Kompleksi skulpturor “Satira në skulpturë” – pjesa 70	Baltë e tharë (e papjekur)	1682
27	Uran Hajdari	Kompleksi skulpturor “Satira në skulpturë” – pjesa 71	Baltë e tharë (e papjekur)	1682
28	Uran Hajdari	Kompleksi skulpturor “Satira në skulpturë” – pjesa 74	Baltë e tharë (e papjekur)	1682
29	Uran Hajdari	Kompleksi skulpturor “Satira në skulpturë” – pjesa 76	Baltë e tharë (e papjekur)	1682
30	Uran Hajdari	Kompleksi skulpturor “Satira në skulpturë” – pjesa 79	Baltë e tharë (e papjekur)	1682

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 8 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006